



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

**KOMISIONI PËR REKRUTIM**

Komisioni për rekrutimin e gjyqtarëve të Gjykatave Themelore, i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me nenin 11, paragrafi 4 dhe 5 dhe nenin 16 të Rregullores 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e gjyqtarëve ("Rregullore"), lëshon këtë:

**NJOFTIM**

Njoftohen të gjithë kandidatët e cekur në listën e bashkangjitur se kanë plotësuar kushtet themelore për t'iu nënshtruar testit me shkrim për gjyqtar nga lëmia penale dhe civile. **Testi me shkrim** do të mbahet me datën 28 shkurt (e mërkurë – penale) dhe 29 shkurt 2024 (e enjte – civile), duke filluar në ora 12:00, në objektin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

- Kandidatët janë të obliguar që të paraqiten për regjistrim jo më vonë se ora 11:45 (në të dyja ditët testuese).
- Kandidatët janë të obliguar që të marrin me vete dokumentin personal për identifikim (letërnjoftimin ose pasaportën). Nuk do të pranohet asnjë dokument tjetër.
- Kandidatëve nuk u lejohet që të kenë në posedim: asnjë lloj shënimi, ligji, materiali lexues apo material përshkrim (letër e pastër), çantë dore, orë dore, letër, stilolaps, laps, fletore, dokumente, telefona, kompjuter, kamera, dëgjuese-kufje, aparat MP3 apo ndonjë pajisje tjetër elektronike të çfarëdo lloji; siç është e përcaktuar me nenin 12 të Rregullores. Shkelja e rregullave të përcaktuara sipas nenit 12 paragrafit 3 të Rregullores, nga ana e kandidatit rezulton me diskualifikimin e tij dhe shpalljen e provimit të pavlefshëm për të.
- Kandidatët të cilët nuk paraqiten në orarin e sipër cekur ose paraqiten pasi që të gjithë kandidatët futen në sallën e mbajtjes së testit me shkrim, nuk do të lejohen të marrin pjesë në test.

Kandidatët e kualifikuar për testin me shkrim janë të listuar si në vijim:

Nr.	Emri	Mbiemri
1	Miljana	Radojević
2	Nebojsa	Sudimac
3	Radomir	Maksimović

Prishtinë,  
20.02.2024

Albert Zogaj



Kryetar i Komisionit Rekrutues

